



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Më 28.08.2024

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi-Nënkryetar i Komunës

Zahir Doda,DKA

Skender Neziri, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Fadil Guri-ZKK

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Shemsedin Abazi-KLSP

Lorik Ramaj-FSK

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës .

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën tonë gjatë periudhës në mes dy takimeve
- 3.Informatë rreth përgatitjeve të vitit të ri shkollor dhe gjendja e sigurisë nëpër shkolla
- 4.Të ndryshme .

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

Për shkak të obligimeve tjera zyrtare të Drejtorit të Arsimit , Kryetari kërkoi që pika e tretë e rendit të ditës të futet si pikë e dytë të cilën kërkesë e miratuan anëtarët e këshillit .

2.Informatë rreth përgatitjeve të vitit të ri shkollor dhe gjendja e sigurisë nëpër shkolla

Zahir Doda – Jemi në prag të vitit të ri shkollorë dhe ne si Drejtori i kemi marrë të gjitha masat për një fillim të mbarë .

Sa për informim gjysëmvjetori parë për dallim nga vitet e kaluara do të përfundojë para vitit të ri .

Si sfidë që kemi është zvoglimi i numrit të nxënësve dhe sistemimi i mësimdhënësve me kontrata të përhershme .

Gjithashtu sfidë është edhe problemi i mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetsore , problem ky që na ka përcjellë me vite .

Përgatitjet teknike për fillimin e vitit të ri shkollorë i kemi bërë me kohë , regjistrimet e fëmijëve për në klasë të parë janë bërë .

Nga ky vit obligative është edhe niveli parashkollorë dhe ne kemi staf të mjaftueshëm për të punuar me këtë kategori të fëmijëve .

Sa i përket nivelit parashkollorë dhe fillor gjithqka është në rregull ndërsa në dy shkollat e mesme sfidë është numri i vogël i nxënësve .

Në Gjimnaz nga 224 të planifikuar, deri tash kriteret i kanë plotësuar 128 nxënës dhe ne si Drejtori jemi dakorduar me stafin e Gjimnazit që të i zbusim kriteret që çdo paralele me i pasë nga 22 nxënës që do të mundësonte ruajtjen e personelit arsimorë.

Kemi një iformacion se në fshatin Doganaj prindërit nuk do të i dërgojnë fëmijët në shkollë deri sa ata të njoftohen se pse shkolla e re e nisur në vitin 2019 nuk ka përfunduar .

Ne si Drejtori me stafin e kësaj shkolle i kemi bërë përgatitjet teknike për të filluar mësimin në këtë shkollë edhe pse kushtet janë shumë të vështira .

Objekti është shumë i vjetër dhe as unë nuk e kam iformacionin se pse kanë ngecur punimet ngase kjo shkollë ka qenë e planifikuar të ndërtohet në vitin 2022.

Objekti është shumë i vjetër dhe as unë nuk e kam informacionin se pse kanë ngecur punimet ngase kjo shkollë ka qenë e planifikuar të ndërtohet në vitin 2022.

Sa i përket stafit arsimorë në përgjithësi jemi të kompletuar pos lëndës së fizikës që nuk po ka kandidat të kualifikuar dhe në gjuhën gjermane që në këtë të fundit jemi munduar të bëjmë një zgjidhje .

Për shkak të shpërnguljeve që janë bërë në fshatin Ivajë ka rënë dukshëm numri i nxënësve ku nga klasa e parë në të nëntën gjithsej janë 11 nxënës .

Edhe këtë vit ne si Komunë kemi vendosur që kjo shkollë të mbahet ndërsa për vitet tjera për shkak të rënjes së numrit të nxënësve vetvetiu edhe mundë të mbyllet .

Kanë përfunduar punimet dhe janë bërë përgatitjet teknike në përirimin e sallës së edukatës fizike në fshatin Biqec dhe kanë filluar punimet në ndërtimin e sallës së edukatës fizike në fshatin Bob.

Tekstet shkollore do të sigurohen sikurse vitin e kaluar e që do të jetë sfidë edhe për prindërit .

Përkundër kërkesës që kemi bërë Drejtorit Komunal në nivelin qendrorë që libri të ofrohet nëpër objekte shkollore për nxënës , ata prap nuk e kanë përfill kërkesën tonë dhe nga ajo që ka ndodhë vitin e kaluar informacionin e kemi se nuk janë siguruar as gjysma e teksteve shkollore por që mjetet financiare kanë dalë në xhirologaritë e prindërve .

Sa i përket gjendjes së sigurisë nëpër shkollë falë bashkëpunimit të mirë që kemi pasur me Policinë ka qenë mirë e që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen .

Në të gjitha shkollat kemi psikolog që kanë kontribuar në ruajtjen e gjendjes së sigurisë por që për këtë vit kam kërkuar që në dy shkollë që frekuentojnë më shumë nxënës ti kemi dy puntorë të kompanisë së sigurimit .

Në përgjithësi mund të them se ne jemi të gatshëm që me 2 shtator të fillojmë me vitin e ri shkollor .

Fadil Guri – Në bazë të informacionit që dha Drejtori përveq një problematike që qenka në shkollën fillore në fshatin Doganaj pjesa tjetër gjithqka qenka në rregull për të filluar viti i ri shkollor .

Mendoj se edhe ne si forum i sigurisë duhet të dalim me një reagim se pse shkollë e re në Doganaj nuk është përfunduar .

Pyetja ime për Drejtorin është se kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e shkollës fillore Emin Duraku .

Zahir Doda – Shkollë do të ndërtohet nga MASHT edhe çka është kërkuar nga ne është leja e ndërtimit të cilën e kemi bërë me kohë dhe ua kemi përcjellë .

Ne me kohë i kemi përgatitur dokumentacionet e leje ndërtimit , mjetet janë ndarë për fillimin e punimeve ndërsa tash është faza e tenderimit që me siguri kjo fazë do të zgjatë .

Ne si Drejtori kemi përgatitë edhe planin B që nëse fillojnë punimet nxënësit të barten në shkollën amë në Dushkajë ku i kemi modifikuar disa hapësira për mbajtjen e orës mësimore .

Para 4 muajve ne kemi lëshuar edhe një lejendërtim për në fshatin Rekë ku është planifikuar ndërtimi i një qerdhe por që ende nuk kemi ndonjë përgjigje se kur do të fillojnë punimet .

Në Kaçanik të Vjetër do të ndërtohet një qerdhe me financim nga Bashkimi Evropian dhe të gjitha punët do të kryhen nga organizata UNOPS .

Gjithçka është gati për të filluar punimet por që për shkak të sanksioneve që ka Kosova nga BE , mjetet financiare ende nuk janë ndarë .

Sipas tyre në momentin kur të hiqen sanksionet ata janë zotuar se mbrenda dy muajve objekti do të jetë gati .

Kryetari – Ankesat e banorëve në fshatin Doganaj janë të arsyeshme por që projekti i filluar në vitin 2019 e që është planifikuar të përfundoj në vitin 2022 është i Ministrisë së Arsimit dhe neglizhenca e tyre ka bërë që ky projekt të mos kryhet .

Gjendja e shkollës së vjetër është alarmante dhe paraqet rrezik për fëmijët ngase siq është publikuar edhe në media në këtë objekt janë shfaqur edhe insekte .

Për kundër kësaj situatë ne duhet të gjejmë një mirëkuptim me banorët dhe fëmijët duhet të fillojn mësimin .

Neglizhenca e nivelit qendrorë është edhe ndaj projekteve tjera që i kemi dërgu të kompletuara ku për 4 vite që po bëhen nuk kemi asnjë mbështetje .

Fidaim Fazliu – Falenderoj Drejtorin për këtë informacion të qartë dhe shqetësuese u paraqit zvogëlimi i numrit të nxënësve sidomos nëpër fshatra si pasojë e migrimit dhe emigrimit .

Shqetësim tjetër u paraqit sistemimi i mësimdhënësve nëpër shkolla që sipas informacioneve që kam po paraqet vështirsi në adaptim me mjedisin e ri të punës .

Një problematikë tjetër e kahmotshme janë edhe problemet shëndetësore të disa mësimdhënësve sidomos ata që janë në prag të pensionimit .

Pyetja ime është se a munden institucionet të bëjnë një zgjidhje për një pensionim të parakohshëm të këtyre mësimdhënësve apo të gjendet një mënyrë tjetër .

Zahir Doda – Ka probleme të ndryshme shëndetësore që preokupohen disa mësimdhënës por që ata edhe vet nuk pranojnë të dalin në pension invalidorë ngase ju zvoglohen të ardhurat .

Kryetari – Me mundësitë tona bugjetore ne jemi munduar që së paku infrastrukturën rrugore ta ndërtojmë në çdo fshat por që edhe sigurimin e transportit të nxënësve e kemi bërë .

Arsyeja e shpërnguljeve është tregu i punës ku shumë banorë të viseve rurale ju është ofruar mundësia e punësimit në Ferizaj dhe për këtë ata kanë lëshuar shtëpitë e tyre dhe janë ofruar më afër vendit të punës

U përmend gjithashtu edhe sfida me gjendjen shëndetësore të disa punëtorëve të arsimit por që nuk është në kompetencën tonë që ta rregullojm qështjen e pensionimit invalidor .

3. Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën tonë gjatë periudhës në mes dy takimeve

Skender Neziri – Situata e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile përkundër asaj se në këtë periudhë kohore ka pasur një frekuentim të madh në komunikacion .

Sfidë për ne ka qenë edhe ajo që për shkak të punimeve që janë duke u bërë në hekurudhë në pjesën e magjistrales qarkullimi i automjeteve është bërë nëpër qytet dhe mendoj se është menagjuar mirë pjesa e trafikut përkundër stafit të ulët që kemi .

Gjithsej kemi 64 raste të veprave penale ku prej tyre janë : 9 vjedhje të shërbimeve, 1 vjedhje e rëndë në tentativë, 2 raste kanosje , sulm ndaj personit zyrtar 2 raste , 1 vetëvrasje , dëmtim prone 4 raste , kanosje 9 raste, sulm seksual 1 rast , dhunë në familje 4 raste , ngacmim 3 raste ,dëmtim i lehtë trupor 4 raste , rrezikim në punë 2 raste , falsifikim i parasë 2 raste , shpërdorim i pasurisë së huaj 1 rast, dëmtim i instalimeve publike 2 raste , posedim i pa autorizuar i lëndëve narkotike 2 raste ,përdorim i armës 2 raste armë mbajtje pa leje 2 raste , tentim vetëvrasje 1 rast , pranim i sendeve të vjedhura 1 rast,shkaktim i rrezikut të përgjithshëm 2 raste , vetë gjyqësi 1 rast , person i zhdukur 1 rast , mashtrim 1 rast dhe sulm 1 rast .

Kemi marrë rekomandime nga Drejtoria Rajonale që të intensifikojmë bashkëpunimin me Drejtoritë e Arsimit për aktivitete të përbashkëta për vetëdijësim dhe ne kemi caktuar ekipet tona për kontakt dhe kordinim të aktiviteteve .

Kryetari – Mundë të them se bashkëpunimi mes Institucioneve Komunale me stacionin e Policisë ka qenë shumë i mirë në çdo iniciativë që është ndërmarrë në të mirë të qytetarëve .

4. Të ndryshme

Naim Hysa – Deshta të shprehë një shqetësim në fillim të rrugës që të qon te shkolla në Dushkajë është bërë dëmtimi i kësaj rruge dhe mendoj që me një intervenim të vogël mundë të rregullohet .

Kryetari – Do e shohim mundësin për intervenim edhe pse kjo rrugë është shumë e ngushtë dhe mundësia për të intervenuar është shumë e vogël për shkak se pronat janë private .

Në këtë periudhë kohore jemi ballafaquar me shumë ankesa të qytetarëve për mungesë të ujit të pijshëm.

Sa për informim ne si Komunë kemi investuar në Ujësjellës por që menagjimi ka ngecë .

Menagjimin e Ujësjellësit e bënë kompania e Bifurkacionit që është në kuadër të nivelit qendrorë dhe mund tju them se asnjë llojë bashkëpunimi nuk kanë ofruar por as që u janë përgjigjur ftesave tona për takime e diskutime rreth kësaj qështje .

Kët problematikë e kam ngritur edhe përmes mediave por që vërejtja ime është sidomos në RTK e cila shkurton intervistën time dhe nuk e shfaqë tërë shqetësimin tim si Kryetar Komune .

Fadil Guri – Është e vërtetë se ka pasur ankesa të shumta për mungesë të ujit të pijshëm por që edhe Komuna ka qenë dashtë që të shtypë disa njoftime e të i shpërndajë në disa vende që të mos e keqpërdorin ujin e pijës ndërsa për menagjim është kompania ajo që mbanë përgjegjesi .

Kryetari – Është e vërtetë që nuk është bërë informimi i qytetarëve se si do të paraqitet gjendja me ujë e gjithashtu për masat që do të ndërmerren për ata që e keqpërdorin ujin e pijes .

Kjo ka qenë neglizhencë e një Zyrtari Komunal të cilit edhe i kam dhënë vërejtje .

Ylber Tusha – Me sa e di unë në rrjetin e ujësjellësit shumë më herët ka pasur kontributdhënës dhe kërkesat për ujë të pijshëm kanë qenë të plotësuara ndërsa tash ky rrjeti i ujësjellësit me at kapacitet të ujit është shpërndarë edhe në disa vende gjë që e ban të pamundur furnizimin e mjaftueshëm . Ndoshta është më mirë të menagjohet prej Komune siq ka qenë edhe më parë.

Kryetari:e kemi provuar që ta marrim në menagjim ne si komunë por që kemi pasur pengesa ligjore që në disa raste na ka kushtuar edhe financiarisht.Ndryshe qëndron puna me kompaninë e pastërtisë ngase e kemi një komunikim më të mirë dhe gjendja në teren sa i përket pastërtisë ka ndryshuar për të mirë.

Fadil Guri: besoj se ujë ka mjaftueshëm por që edhe keqpërdorimet janë duke u bërë nga vet qytetarët,kështu që ne duhet të marrim masa paraprake që të ndalojmë këtë dukuri.

Nënkryetari:kompanisë së bifurkacionit i mungon edhe stafi i punëtorëve ku në bazë të informacionit që kam ata kanë vetëm një puntorë në teren e poashtu ju mungon edhe makineria, që don të thot se kjo kompani nuk menagjohet si duhet.

Jashar Selimi: si dukuri shqetsuese shoh që është edhe ekspozimi i fëmijëve të mitur para alkoholit në lokale hoteljere por që ka edhe fëmijë të moshës nën 18 vjeq që shërbejnë nëpër këto lokale.Më intereson të dijë se a ka ndonjë mekanizëm shtetrorë që mirret në parandalimin e kësaj dukurie.

Kryetari:shqetësimi i juaj është me vend dhe për këtë qështje mendoj se duhet të mirret inspektorati i punës që ne si komunë nuk e kemi si dikaster që vepron në kuadër të inspektoratit.Ne këtë shqetësim mundemi ta ngrisim në kuadër të takimeve që mbajmë me nivelin qendrorë.

Rekomandimet

1. Të mirren masa ndaj personave që keqpërdorin ujin e pijes .
2. Të mirren masa paraprake ndaj çdo dukurie që cenon sigurinë qytetare
3. Të bëhen kërkesa të vazhdueshme nivelit qendrorë për projekte që ndryshojnë për të mirë jetën e qytetarëve.
4. Të mirren masa ndaj lokaleve hoteljere që kanë të punuar fëmijë dhe që i ekspozojnë para pijeve alkoholike.
5. Të bëhet publike neglizhenca e nivelit qendrorë dhe kompanive që pa ndonjë arsytim i ndërpresin projektet e filluara.
6. Të gjindet një zgjidhje për mësimdhënësit që kanë probleme shëndetsore gjë e cila e vështirson procesin mësimorë

Kryesoi: Kryetari – z. Besim Ilazi



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka